

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISËNr. 1424 Prot.Tiranë, më 23 07 2020

Drejtuar: **Z. Petrit Ahmetit**
Kryetar
Enti Rregullator i Energjisë

Për dijëni: **Znj. Matilda Kërçaku**
Kryetar
Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAZ sh.a.

Për dijëni: **Z. Arbër Avrami**
Administrator
ALBGAZ sh.a.

Lënda: Dërgohet Raporti Vjetor i Përputhshmërisë së ALBGAZ sh.a. (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror) për vitin 2019

I nderuar z. Ahmetaj,

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015), në zbatim të kërkesave të nenit 47, Programi i Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 "Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror", miratuar nga ALBGAZ sh.s. me vendim nr. 18, datë 14.11.2019 mbi "Miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror".


Në përmbushje të detyrave të lëna në vendimin e ERE Nr. 78, datë 26.05.2017 "Mbi miratimin e kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë në sektorin e gazit natyror", bashkëlidhur do të gjëni, Raportin Vjetor të Përputhshmërisë për vitin 2019 për ALBGAZ sh.a (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror), përgatitur nga Zyrtari i Përputhshmërisë.

Shënim: Për shkak të situatës të paprecedent të COVID-19 dhe me karantinimin e personelit, si unë dhe kolegët e ALBGAZ e kemi patur shumë të vështirë verifikimin e të dhënave finale, rishikimin e shkresave, përditësimin e informacionit për përfundimin e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë 2019 për ALBGAZ sh.a. Për këtë arsye Raporti u botua me vonesë, më saktë me datë 23.7.2020.

Me respekt,

ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Elvis Ponari MBA, MSc





ALBGAS sh.a.

OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR

ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. 1426 Prot

Tiranë, më 23/07/2020

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2019

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAS Sh.a.**

ALBGAS Sh.a
Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror
Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovarëve,
Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri
www.albgaz.al
NUIS: L71306034U

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË

2019

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAZ Sh.a.**

Tiranë, 2020

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAS Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përmbushjes së përgjegjësive të tij në vitin 2019.

Në zbatim të kërkesave të nenit 47, nenit 16 pika 7 të Ligjit 102/2015 datë 23.09.2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE nr.77, datë 26.05.2017, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAS Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

Shënim: Për shkak të situatës të paprecedent të COVID-19 dhe me karantinimin e personelit, si unë dhe kolegët e ALBGAS e kemi patur shumë të vështirë verifikimin e të dhënave finale, rishikimin e shkresave, përditësimin e informacionit për përfundimin e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë 2019 për ALBGAS sh.a. Për këtë arsye Raporti u botua me vonesë, më saktë me datë 23.7.2020.

Përgatiti:

Elvis Ponari MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë

Email: elvis.ponari@albgaz.al

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

ALBGAZ sh.a: Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Nat.

ALBPETROL sh.a: Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit

ERE: “Enti Rregullator i Energjisë”

OSSH/DSO: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”

OST/TSO: “Operator i Sistemit të Transmetimit”

ENTSO-G: është Rrjeti European i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (observer)

MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

GNL: “Gaz Natyror i Lëngshëm”

MEDREG: Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut

ECRB: Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vendeve të Komunitetit të Energjisë

ACER: Agjencia për kooperim e rregullatorëve të energjisë për Europën.

CEER: Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë

GRI SSE: Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje

IGU: Unioni Ndërkombëtar i Gazit, jemi anëtarë me të drejta të plota

OME: Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë

UfM: Unioni për Mesdheun

Përmbajtja

PJESA E PARË.....	6
1. Hyrje	6
2. Kompania.....	7
3. Programi i Përputhshmërisë.....	9
A. Ndarja dhe pavarësia e OST	10
1. Ndarja e OST	10
2. Pavarësia drejtuese e OST	10
3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse e OST.....	11
B. Përjashtimi i sjelljes diskriminuese.....	14
1. Aksesimi në sistemin e transmetimit	14
2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale.....	15
3. Konflikti i interesit.....	15
C. Politika e informacionit të kompanisë OST	15
1. Sigurimi i informacionit.....	15
2. Konfidencialiteti i informacionit	16
3. Informacioni publik	17
D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë	17
PJESA E DYTË	18
4. Rekomandimet e pranuar të Zyrtarit të Përputhshmërisë.....	18
5. Rekomandimet e Zyrtarit të Përputhshmërisë për vitin 2020	18
PJESA E TRETË	20
6. Detyrat specifike të lëna nga ERE mbas miratimit të Raportit 2018.....	20
PJESA E KATËRT	21
7. Konkluzione.....	21

PJESA E PARË

1. Hyrje

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 178, datë 15.10.2015), në zbatim të kërkesave të nenit 47, Programi Tip i Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 77, datë 26.05.2017 “Mbi miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”. Gjithashtu në mbështetje të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC” u hartua ky raport. Raporti vjetor u hartua në bazë të detyrave të Zyrtarit të Përputhshmërisë, Z. Elvis Ponari MBA, MSc (Zyrtari), miratuar me Vendimin Nr. 233, datë 16.10.2018, “Mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së ALBGAZ të Gazit Natyror nga ERE.

Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet për herë të dytë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. (OST) në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të OST në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2019 nga Këshilli Mbikëqyrës i OST me vendim Nr 18, datë 04.11.2019 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, por akoma jo të miratuar nga ERE. *ERE me vendimin nr. 221 prot datë 20.12.2019 ka kërkuar dërgimin e programit për miratim tek Asambleja, për arsye se në vendimin e OST thuhej “Vendimi duhet të miratohej nga Asambleja” nuk është pranuar nga ERE.*

Programi është bërë me qëllim sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të OST-së ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisë së OST, konfidencialitetin e të gjithë informacionit të menaxhuar nga OST-ja si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj përgjatë periudhës 1.1.2019 – 31.12.2019.

Zyrtari konstantoi që OST është në përputhje me standartet e industrisë, ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2019 e analizoj kompaninë sipas Programit dhe ushtroi detyrën e tij që Programi të zbatohet nga kompania. Gjithashtu përgjatë 2019 Zyrtari është kujdesur që kompani të respektoj dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari sëbashku me OST kanë krijuar rregulloret, udhëzime dhe procese në mënyrë aktive në mënyrë që kompania dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshmëri me Programin.

Raporti i vitit 2018 parashtroi disa rekomandime që duhet të ishin plotësuar përgjatë 2019, për përmirësimin e punës në OST dhe përmbushjet e detyrimeve të Programit. Këto rekomandime do rishikohen dhe njëherë të plotësohen nga OST në vitin 2020.

Rekomandimet ishin:

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2019

- Përditësimi i faqes zyrtare të OST për të përfshirë Programin e Përputhshmërisë
- Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin
- Manual Pune: Parimet e Programit të Përputhshmërisë
- Udhëzues për Politikat e klasifikimit të dokumentacionit
- Përditësim/përmirësim i Programit
- Aplikacion/mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.
- Paraqitja e teknikave të reja për trajnimet e stafit

Sipas shkresës së ERE nr. 411/1 prot. Datë 26.08.2019 “Kërkesë për informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të zyrtarit të përputhshmërisë OST”. OST me shkresën Nr. 87 prot. Datë 12/09/2019 kanë kthyer përgjigje : rekomandimet nuk janë plotësuar. Zyrtari me shkresën Nr. 71 prot. Datë 04.03.2020 lënda “kërkohet informacion mbi masat e marra për rekomandimet e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë së OST për vitin 2018” ka marrë përgjigje nga OST me shkresë zyrtare ku deklaron që nuk janë plotësuar akoma dhe këto rekomandime do plotësohen përgjatë vitit 2020.

Për plotësimin dhe miratimin e programit të përputhshmërisë ka patur vonesa për arsye të ndryshme, por me ndihmën e Zyrtarit së bashku me stafin e OST u finalizuan në kohë.

2. Kompania

OST është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a.. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu kompania ka nje zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

OST është certifikuar nga ERE si një **transmetues i kombinuar gazi dhe shpërndarës** me Vendimin e Bordit të ERE nr. 179, datë 8.11.2017 "Për certifikimin e kompanisë si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror". Me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **shpërndarjes** së gazit natyror, dhe vendimin nr. 188, datë 10.11.2017 është licensuar si kompani në veprimtarinë e **transmetimit** të gazit natyror. Përgjatë vitit 2019, OST me shkresën Nr. 8 prot. Datë 01.09.2019, ka patur komunikim me Bordin, në bazë të Gaz Master Planit të gazit natyror për Shqipërinë dhe identifikimi i projekteve prioritare në fushën e gazit natyror, për të marrë tagerin që të liçensohet si **Depozitar gazi për projektin Dumrea 2**. Ky projekt kushton rreth 73 milion eur me kapacitet magazinues rreth 1-1.2bnk gaz. Duke qënë se TAP kalon nëpër Shqipëri, dhe duke qënë se Shqipëria ka burime natyrore për grumbullimin e gazit është me interes krijimi i një depozitë të tillë. ERE e ka miratuar me vendimin Nr. 190, datë 25.11.2019 “Mbi kërkesën e shoqërisë OST për licensimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”, pasi OST me shkresën nr. 729 Prot, datë 11.11.2019, paraqiti në ERE aplikimin dhe përmbushi kushtet për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

Rrjeti i tubacioneve në pronësi të OST është i shpërndarë në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë dhe përfundon në ORC në Ballsh. Infrastruktura vendase e rrjetit të gazit në Shqipëri ka një shtrirje më të madhe se infrastruktura e naftës. OST ka informuar se aktualisht është në procesin e evidentimit në terren, vlerësimin teknik të integritetit të linjave teknologjike dhe

tubacioneve nëntokësore si dhe vlerësimi i ndikimit në mjedis, për efekt të paisjes me Lejen Mjedisore

Fushat e gazit shtrihen nga Durrësi deri në Delvinë, duke krijuar kështu një mundësi për konsumatorët për t'u lidhur me rrjetin. Infrastruktura e kufizuar e gazit vendas në Shqipëri në disa pjesë të saj është jashtë gjendjes operative dhe nevojiten punime të mëdha rehabilitimi. OST administron rreth 500 km tubacione magjistrale të transportit të gazit të ndertuar para më shumë se 40 vjetesh. Mendoj që tani ato janë me një teknologji tashmë të vjetëruar, ku masat mbrojtëse nga korozioni janë minimale.

Aktualisht objekti kryesor i aktivitetit të OST si një operator i kombinuar, është të ofrojë transportimin dhe shpërndarjen e gazit natyror nëpërmjet rrjetit të trasmetimit dhe shpërndarjes, dhe në të ardhmen të ofrojë edhe aktivitetin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror dhe të impiantit të gazit natyror të lëngëzuar.

OST si operator i kombinuar i gazit përgjatë 2019 ka proçeduar për mbylljen e kërkesave ligjore përsa i përket çertifikimit dhe licensimit të shoqërisë me shkresat:

- Nr. 22 prot. Datë, 27.2.2019 mbi “Kërkesë për shtyrje afati të vendimit mbi licensimin e Shoqërisë ALBGAS sh.a.” ka kërkuar kohë për plotësimin e dokumentacionit të munguar deri në 20.12.2019.
- ERE me shkresë Nr. 36 dhe Nr. 37, datë 04.03.2019 mbi “Një ndryshim në vendimin e bordit të ERE Nr.187, Datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendim nr 261, datë 19.12.2018, “Për licensimin e Shoqërisë ALBGAS sh.a në aktivitetin e shpërndarje së gazit natyror”, pranoj dhe vendosi: të shtyjë licensimin e OST deri më 20.12.2019 duke i dhënë kohë që OST të prodhojë:
 1. Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licensën e kërkuar.
 2. Lejet dhe autorizimet mjedisore
 3. Një çertifikatë sigurimi nga një shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD.

Gjithashtu duhet theksuar insistimi i ERE ku me vendimin nr. 63, datë 23.04.2019 për një ndryshim në vendimin e bordit ERE nr.179, datë 8.11.2017, “mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” ALBGAS sh.a.”, vazhdon kërkon plotësimin e kushteve të parashtruara për licensim, një nga këto kushte duke qenë Progami.

OST përgjatë 2019 ka qarritur të përmbushë dhe të plotësojë një pjesë të kushteve për licensim dhe çertifikim dhe me shkresën Nr. 51 prot. Datë, 17.05.2019 “Përditësim rreth statusit të aseteve” ka përfunduar këtë kërkesë ligjore dhe e quan të ezauruar. Me shkresë Nr. 52 prot. Datë, 17.05.2019 OST informon dhe për rritje kapitali pasi u shtuan asetet e reja në pronësi të OST.

ERE me vendim Nr.220, datë 20.12.2019 vendosi për licensimin e OST, konstatoi që:

- Shoqëria “ALBGAS” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 51 prot., datë 17.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 266/4 prot., datë 20.05.2019, si dhe shkresës nr. 52 prot, datë 17.05.2019, protokolluar në ERE me nr. 354 prot., datë 20.05.2019, ka bërë me dije ERE-n për mbylljen

e procesit të pajisjes me certifikata pronësie dhe ka njoftuar për zmadhimin e kapitalit. **ERE e quan të ezauruar këtë kusht.** Në vijim, OST i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 122 Prot., datë 02.12.2019, protokolluar në ERE me nr. 196/1 Prot, datë 02.12.2019, me anë të së cilës **ka kërkuar shtyrjen e afatit të liçensimit e të plotësimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.06.2020**, duke u shprehur se pajisja me dokumentet e kërkuara është një proces që kërkon kohë dhe është në varësi të përgjigjes nga institucionet përkatëse. Gjithashtu me qëllim plotësimin e dokumentacionit, OST ka marrë në konsideratë udhëzimin e parashtruar nga AKM për të aplikuar për një leje të re mjedisore, nga ku rrjedh edhe urdhëri i administratorit të shoqërisë Albagaz Sh.a me Nr. Prot 2/1 datë 09.01.2020 “Pagesë për aplikim të lejes mjedisore për veprimtaritë që kanë ndikim ndaj mjedisit” është autorizuar drejtoria e fiancës që të procedohet me likuidimin e faturës Nr.2 datë 09.01.2020 për aplikim të lejes mjedisore për veprimtari që kanë ndikim ndaj mjedisit, leshuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila duhet paguar nga shoqëria Albagaz Sh.a në numrin e llogarisë së Ministrisë. Kjo pagesë është akzekutuar nga shoqëria sipas urdhërit në fjalë, ku aktualisht po ndiqet me prioritet, gjithashtu, OST ka informuar. OST deklaroi se ka parashikuar në Programin e zhvillimit ekonomik për vitin 2020, pagesën e certifikatës së sigurimit si shoqëri sigurimi. *ERE vendosi të licencojë OST në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.06.2020, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.*

Dhe ERE me vendim Nr. 221, datë 20.12.2019 vendosi për **çertifikim** e OST:

- të shfuqizojë kërkesën për pajisjes me certifikata pronësie të asetëve të mbetura pasi është **ezauruar**; *OST duhet të dorëzojë deri më 20.06.2020 Programin e Përputhshmërisë dhe plotësimin e dokumentacionit të munguar; OST të marrë masa brenda datës 20.06.2020 lidhur me zbatimin e ndarjes së pronësisë në përputhje me parashikimet e nenit 36 pika 2 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”;* Nëse ndarja e pronësisë së OST nuk është bërë sipas nenit 36 pika 2 gërma “a” dhe “b” të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, brenda datës 20.6.2020, ERE ka të drejtë të rishikojë vendimin nr.179, datë 08.11.2017, “Për çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAS sh.a.

Përgjatë 2019 OST ka ndryshuar anëtarët e bordit të tij duke e konfirmuar me shkresën Nr. 78 prot. Datë 24.07.2019. Dhe me shkresën nr. 97/1 prot. Datë 07/01/2020 “Për një ndryshim në Këshillin Mbikëqyrës” ndryshoi përsëri këshillin mbikëqyrës duke u plotësuar me anëtarët e saj.

3. Programi i Përputhshmërisë

Parimet e programit që qeverisin aktivitetin e OST

Monitorimi i përmbushjes së këtyre detyrimeve është bazuar në katër parimet themelore (**ndarja dhe pavarësia, aksesit dhe shpërndarja e informacionit, përjashtimi i sjelljes diskriminuese dhe zbatimi i rregullt i programit**) të programit sipas Vendimit të Bordit të ERE Nr. 77, datë 25.06.2017 “Mbi Miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror”, shqyrtohet se si aktiviteti i OST duhet të qeveriset sipas standarteve që përcakton legjislati në fuqi.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2019

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2019 nga Këshilli Mbikëqyrës i OST me vendim Nr 18, datë 04.11.2019 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”

Kërkesat dhe parimet e mëposhtme rregullatore duhet të konsiderohen prioritare për OST., dhe çdo strukturë e saj është e detyruar të realizoj dhe kërkojë përputhshmërinë me këto kërkesa dhe parime.

A. Ndarja dhe pavarësia e OST

1. Ndarja e OST

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e programit** pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Gjithashtu, OST është një person juridik i ndarë që nuk është pjesë e kompanive vertikalisht të integruara ose pjesë e strukturës së korporatës dhe nuk kryen dhe as nuk është e angazhuar në aktivitetet e prodhimit dhe/ose furnizimit të gazit natyror dhe energjisë elektrike.
- OST sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit , dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: ka siguruar dhe garantuar ndarjen e duhur të OST, duke marrë masa që i njëjti person ose të njëjtët persona të emëruar, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht OST të mos kenë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e subjektit që kryen veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror, si dhe të jenë anëtarët të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e OST ose rrjetit të transmetimit.

2. Pavarësia drejtuese e OST

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe nënpikat e saja, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit** duke marrë masa që për të arritur pavarësinë e drejtuesve. Për sa i përket pavarësisë së drejtuesve të OST, të tillë si Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, Administratori, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njësive strukturore), janë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, janë zbatuar kërkesat e mëposhtme:
- Drejtuesit e OST nuk janë të lidhur profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të këtyre.

- Drejtuesit e OST nuk kanë interes apo marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtperdrejtë ose të tërthortë, për kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Pagat e drejtuesve në OST vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e OST, siç specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit.
- Transferimi i drejtuesve të OST tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, është parashikuar të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statuti i OST dhe do ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferime nuk duhet të paracaktohen që në fillim. Drejtuesit e OST nuk kanë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe nuk ka konflikte të mundshme interesi që kanë lidhje me këto aksione.

3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse e OST

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse.** OST mbështetur në Ligjin nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit është përgjegjës për dhënien aksesit për palët e treta, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, OST është përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re të gazit. OST është e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetë-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë. OST mban në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

Një kërkesë ligjore e mbartur nga viti 2018 ka të bëjë me shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2018 dhe planit 10-vjeçar 2018-2027 të zhvillimit të rrjetit të OST. ERE me vendim nr. 14, datë 31.01.2019, vendosi të refuzojë miratimin e planit të investimeve për vitin 2018 të OST, Pika 2 e Vendimit Nr. 235, datë 02.11.2018, ndryshon dhe bëhet: - “ALBGAZ” sha, *të depozitohet pranë ERE-s jo më vonë se data 31.10.2019: miratimin nga Këshilli Mbikqyrës, të Planit të zhvillimit të rrjetit për periudhën 2019 – 2028, që reflekton ndryshimet në Planin 10-vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit sipas shkresës Nr. 10 prot. datë 24.01.2019.*

Gjithashtu nga OST përgjatë 2019, kemi bashkëpunim dhe komunikim të mirë me ERE-n ku sëbashku kanë përmirësuar tregun e gazit nga ana rregullative për të ardhmen. ERE me vendim Nr. 53 prot. Datë 03.04.2019 filloi procedurën për “Rregulloren për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror” dhe OST me shkresën 50 prot. Datë 13.05.2019 shpreh dakortësinë për këtë rregullore. Kjo rregullore u miratua me vendim të ERE-s Nr. 100, datë 21.06.2019 “Rregullore për përcaktimin e kriterëve standarde dhe kërkesave minimale të cilësisë së shërbimit dhe furnizimit të rrjeteve të gazit natyror”.

Tjetër bashkëpunim ndërinstitucional kemi dhe miratimin e vendimit Nr. 76, datë 31.05.2019 “Rregullores mbi Sistemin e Njësuar të Llogarive për Shoqëritë e Rregulluara në Sektorin e Gazit Natyror, përfshirë Auditimin e Llogarive”. Dhe për fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së lidhjeve të reja në rrjetin e gazit natyror” miratuar me vendim nr. 176, datë 14.11.2019.

Një funksion rregullativ të përmbushur mirë nga OST ka qënë përpunimi dhe krijimi i Kodit të Rrjetit, ku në bashkëpunim me BERZH kanë krijuar një dokument rregullativ shumë të kërkuar dhe koherent për tregun e gazit. ERE me vendim Nr. 56, datë 03. 04.2019 ka filluar rocedurën për transpozimin e rregullores 2017/459 të miratuar me vendim Nr. 2018/06/PHGL-ENC “mbi themelimin e kodit të rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror”. Dhe me vendimin Nr. 168, datë 04.11.2019, vendosi të fillojë procedurën për miratimin e “Kodit të Rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”. Ndërsa me vendim nr. 231, datë 20.12.2019 miratojë “Kodin të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit”.

ERE me shkresën Nr. 717 prot. Datë 7.11.2019 ka dërguar vendimin Nr. 166, datë 04.11.2019 për “rregulloren mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror”. Nga ana tjetër rregullative, OST si operator i gazit natyror ka për detyrë dhe është përgjegjës për organizimin e tregut të gazit natyror. OST do të hartojë akte nënligjore të cilat rregullojnë sektorin e gazit natyror, me kërkesë nga ERE me Nr. 706 prot. Datë 6/11/2019. OST me shkresë kthim përgjigje nr.87, datë 12.9.2019 është shprehur: se ERE duhet të përzgjedhi Operatorin e tregut sipas dispozitave të nenit 85 të ligjit Nr 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

OST ka ushtruar dhe shumë aktivitete të tjera në sektorin e brëndshëm dhe ja vlen të përmëndin:

- Rritjen e Kapaciteteve në aspektin “komercial”, trajnim i stafit me “commercial game”;
- Rritje të kapaciteteve teknike me trajnim të stafit OST, të organizuar nga USAID, Network Simulating Platform “SIMONE”;
- Rritjen e Kapacitetit në drejtim të CAPEX të TSO-së;
- Kërkime Tekniko-Financiare për realizmin e një “projektit pilot” të GNL në “shkallë të vogël” ;
- Ndjekjen e zhvillimeve të një projekti të parë të rëndësishme të transmetimit për OST (PIP1) siç është Gazsjellësi FIER-VLORE që do të furnizojë TEC-in e Vlorës (TPP) me gaz.
- Përfundimin e ndërtimit të Filialit të Fierit, i cili i është dhënë me qera për “Albania Gas Services” (AGS), kompanisë së mirëmbajtjes së TAP, të krijuar nga OST dhe SNAM.
- Është përfunduar procedura e marrjes në pronësi të “truallit”, në Zonën e Korçës, mbi të cilën do të ndërtohet Qendra e Mirëmbajtjes (MQ) e OST për zonën Jug-Lindore të Shqipërisë. Edhe kjo MQ i është lënë me qera AGS me objekt pune “Mirëmbajtjen e TAP”.
- Kanë filluar dhe janë në proces procedurat për projekt idenë e MQ, sipas standarteve minimal të TAP dhe të partnerit të OST, SNAM. Duke qënë një objekt me funksione “industriale” MQ ka nevojë të projektohet sipas disa standarteve të caktuara për aktivitetin e mirëmbajtjes së aseteve të tubacioneve të gazit nën presion të lartë.
- Pjesëmarrje në Panairët e organizuara në vend, si në atë të specializuar për “energji” shtator 2019 ashtu dhe në atë “të përgjithshëm” nëntor 2019, me qëllim rritjen e visibilitetit të OST dhe veprimtarisë së tij, në funksion të rritjes së “ndërgjegjësimit të publikut” për sa zhvillimet në sektorin e gazit, një proces afat-gjatë i “marrëdhënies me tregun”.

Kurse në sektorin e jashtëm ja vlen të përmëndin:

- Janë në proces negociimet në nivel teknik me TAP për piken e daljes ne FIER, parashikuar minimalisht për një kapacitete 80,000 N m3/orë ose afërsisht 0.7 Bcm/vit.

- Ndjekja e procesit të zbatimit në praktikë e kontratës së mirëmbajtjes së TAP midis AGS dhe TAP, e cila është nënshkruar në dhjetor të 2018.
- Përfundimi i procedurave për aprovimin e gjithë dokumentacionit fillestar dhe autorizimet përkatëse për krijimin e IAP, (Ionian Adriatic Pipeline shpk), midis Shqipërisë, Malit të Zi, Bosnje-Herzegovinë dhe Kroacisë dhe memorandumet e mirëkuptimit midis IAP dhe TAP, si edhe IAP dhe SOCAR.
- Forcimin e bashkëpunimit institucional me Komunitetin e Energjisë në kuadër të WBIF (Western Balkans Investment Framework).
- Forcimin e bashkëpunimit institucional ENTSO-G, duke konsideruar anëtarësinë e plotë të OST-së. Deri tani OST i ndjek aktivitetet e ENTSG me statusin e “vrotuesit” (observer).
- Ndjekjen e punës për rezultatet e fizibiliteti për projektin e interkoneksionit me Kosovën i njohur ndryshe si “ALKOGAP”.

Viti 2020 e pret OST me zhvillimi në fushën e gazit si:

- Përpjekjet për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri gjatë vitit 2020 e më tej, vijnë natyrisht nga prania dhe operimi i TAP, i cili do të filloj punën në vitin 2020 me transmetimin e gazit nga Azerbajxhani në Itali. Qeveria ka aprovuar tashmë që në 2016-n Master Planin për Zhvillimin e Tregut të Gazit Natyror në Shqipëri, një projekt i financuar nga Organizata Europiane dhe që vlerëson potencialet e zhvillimit të Sektorit të Gazit Natyror në “Shqipëri, në kohë (20 vitet e ardhshme), në teknologji dhe në konsiderata financiare”. Kalimi i gazit nëpër Shqipëri mundëson që Shqipëria të presi disa zhvillime të rëndësishme energjetike, në linjë me ato të këtij sektori në industrinë globale, si: (i) zhvillimin e prodhuesve të mëdhenj të energjisë ose TEC-eve me gaz, si version më i “pastër” në shfrytëzimin e hidrokarbureve për prodhim energjie, (ii) furnizimin e konsumatorëve industrialë, duke mundësuar uljen e kostos së tyre të prodhimit, por edhe (iii) furnizimin e konsumatorëve rezidencialë.
- Një nga zhvillimet/parashikimet e para të sektorit do të jetë linja e gazsjellësit Fier-Vlorë, me një qëllim të dyfishtë, furnizimin me gaz të TEC-it të Vlorës dhe zhvillimin e rrjetit të distribucionit në qytetin e Vlorës në mbështetje të industrisë, bizneseve lokale dhe gjithashtu tregut rezidencial.
- Qarku i Fierit është gjithashtu në zhvillim paralel nga prania e TAP-it në vend. Afërsia me tubacionin e TAP, përqëndrimi i disa industrive konsumatore tradicionale të gazit, kultura praktike edhe familjare e përdorimit të gazit për shkaqe historike, e bën shumë të mundshme zhvillimin e tregut industrial e rezidencial në këtë qytet.
- Qarku i Korçës, qyteti në veçanti, po bëhet “objekt” i zhvillimit të tregut dhe i “kapitalizimit” të përfitimeve që ka Shqipëria nga kalimi i TAP nëpër territorin e saj.

Por ndërsa objektivat afatshkurtra të zhvillimit të sektorit janë këto si më sipër, ato afatmesme përfshijnë objektiva edhe më impenjuese, si në financim ashtu edhe në volume pune si: lidhja e zonës më të zhvilluar ekonomike të Shqipërisë Tiranë-Durrës si dhe ajo e Elbasanit, për shkak të konsumatorëve të mëdhej industriale të energjisë që ka ky qytet. Në këtë kuadër OST po ndjek dhe po përfshihet në përpjekjet e Departamentit Amerikan të Energjisë, i cili së bashku me MIE organizoj seminarin e parë në Shqipëri “Zgjidhjet në shkallë të vogël për organizimin e shpërndarjes së GNL me kontener”.

Në bashkëpunim me BERZH (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) OST po punon për trajnimin e specializuar të stafit të vet nën drejtimin e “Drejtorisë Komerciale dhe Rregullatore” për të zhvilluar trajnime dhe suport si: përfundimit të kodit të rrjetit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave, koncepteve komerciale vendore dhe ndërkufitare, në balancimin e gazit natyror, alokimit të kapaciteteve si dhe operimit të sistemit të rrjetit, etj. Të gjithë këto elemente janë

njohuri bazë themelore për krijimin e një OST apo “Operatori të Sistemit të Transmetimit”, i cili në fakt përbën edhe aktivitetin kryesor.

Po punohet prej vitit 2019 me BERZH edhe për një asistencë në Drejtorinë Juridike të OST, për të përfituar eksperiencë në “kuadrin kontraktual të një TSO”. Asistencë sipas llojeve të ndryshëm të pjesëmarrësve në treg, si psh “Kontrata TIP” për: interkoneksionin, shipper-in, trader-in, depozitimn nëntokësor, etj.

Në kushtet që ndodhet tregu i gazit në vënd; zhvillimi i aktivitetit të OST dhe zhvillimi i tregut të gazit është një proces i rëndë si në volume projektimi dhe financimi. Kërkohen gjithashtu dhe burime njerëzore të mëdha dhe të kushtueshme, sëbashku me shtrirje kohore të zgjeruara. Por për të arritur këto rezultate në mënyrë graduale duhet që OST të:

- Krijoj kushtet për përfitimn e investimeve të huaja direkte në këtë segment të industrisë;
- Rritjen e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
- Përmirësimin e furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
- Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kostosh energjitike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
- Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
- Krijimin e kapaciteteve njerëzore në vënd në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

B. Përrjashtimi i sjelljes diskriminuese

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit, për të parandaluar ndonjë trajtim diskriminues nga ana e OST.

1. Aksesin në sistemin e transmetimit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit** duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues. OST gjatë vitit 2019 i ka dhënë akses në sistemin e transmetimit të gazit shoqërisë ALBPETROL Sh.a. Për vitin 2019, ERE e miratoj kontratën me vendim nr. 230, datë 20.12.2019 Kontratën me nr. 1026 Prot., të ALBPETROL sh.a, datë 04.02.2019 dhe nr. 25 Prot., të ALBGAS sh.a, datë 25.02.2019, të lidhur ndërmjet shoqërive ALBPETROL sh.a dhe ALBGAS sh.a, për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat një vjeçar duke filluar nga data 01.01.2019 - 31.12.2019. Tarifa e transmetimit të gazit e aplikuar për vitin 2019 ka qënë 28leke/m³ nëpërmjet kontratës së transmetimit të nënshkruar mes palëve. Procedura ka filluar me vendimin e ERE Nr. 49, datë 27.03.2019 mbi “Fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, të lidhur ndërmjet shoqërisë OST dhe shoqërisë ALBPETROL për vitin 2019”. Ka pasur komunikim të vazhduar midis OST dhe ALBPETROL për të ribërë kontratë të re në bazë të kërkesave të gazit që i nevojiten ALBPETROL. Me shkresën e ERE nr. 227/8 prot. Datë 4.07.2019 me subjekt njoftim për zhvillimin e një seance dëgjimore” është përditësuar kontrata ku ALBPETROL nga sasia 770.000 Nm³ për vitin 2019 do këkojë 600.000 Nm³ për vitin 2020 (në 2018 ka qënë 2.651.000 Nm³). Ky ndryshim rënie sasive gazi ka krijuar një dëm financiar tek OST. Presim të zhgjidhet tek seanca tjetër dëgjimore në vitin 2020.

Do sygjeroja që kontrata të përditësohet në kohë dhe sa më parë duke patur një takim dhe një bashkëbisedim midis dy palëve pasi ALBPETROL të evidentojë sasinë e gazit që kërkon. Rinovimi i kontratës nuk varet plotësisht nga OST, pasi OST ka ridërguar shkresën me nr. 91/1 prot. Datë 09.10.2019 me subjekt “rikujtim mbi sasinë e gazit të programuar dhe buxhetuar për vitin 2020” tek ALBPETROL, por pa përgjigje nga ata. Për këtë arsye OST i ka kërkuar ERE një ndërmjetësim midis dy palëve.

2. Konkurrenca dhe marrëdhëniet komerciale

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafit të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e programit.** Për sa i takon konkurrencës dhe marrëdhënieve komerciale, përgjate vitit 2019 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të vecanta. Aktivitetet e OST nuk kufizojnë ose ndikojnë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror

3. Konflikti i interesit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit.** Në lidhje me konfliktet e interesit, përgjatë vitit 2019, nuk është sinjalizuar asnjë shkelje apo abuzim i punonjësve të shoqërisë OST nga ana e Bilbilfryresit apo e ndonjë individi tjetër të brendshëm apo të jashtëm të shoqërisë.
- Në vitin 2019 tarifa e gazit në Shqipëri ka mbetur si vitin e kaluar prej 28lekë/m³ deri me datë 31.12.2019 ku ERE përkohësisht vendosi tarifën e gazit me vendim Nr. 60, Datë 15.04.2019 mbi “miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria OST, prej 28lekë/m³ ose 2.6457lekë/kwh, deri më datë 31.12.2019. ERE me vendim nr. 186, datë 25.11.2019 vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e Draft – “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”. ERE me vendimin nr. 206, datë 16.12.2019 vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit Nr. 60, datë 15.04.2019, të Bordit të ERE-s për vitin 2020 deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë OST. Për tarifën e vitit 2019 kemi një ankesë dhe padi nga ANOIL tek ERE ku kërkon shpjegim dhe ritrajtim të tarifës vjetore të transmetimit të gazit. Kjo padi është pastaj tërhequr nga ANOIL pasi tarifa miratohet nga ERE dhe jo nga OST.

C. Politika e informacionit të kompanisë OST

OST ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

1. Sigurimi i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit.** Pavarësisht faktit se aktualisht OST ka vetëm një përdorues të rrjetit të transmetimit të gazit, OST i siguron atij, pjesëmarrësve potencial dhe përdoruesve të mundshëm të rrjetit informacionin e nevojshëm për akses eficient dhe të pa-kufizuar tek sistemi i transmetimit. Ky informacion sigurohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe jo-diskriminuese sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin Nr 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, akteve të tjera ligjore në fuqi dhe Kodin e Rrjetit të Transmetimit të miratuar së fundmi nga ERE me Vendimin Nr. 68 datë 22.04.2020 i cili gjithashtu në disa nene të tij siguron pikërisht informacionin dhe konfidencialitetin. Aktualisht po punohet për përditësimin e faqes së web-it ku do të publikohen informacione për publikun në mënyrë që i gjithë sistemi i transmetimit të gazit natyror të jetë i aksesueshëm nga operatorët e tjerë të sistemit të transmetimit, operatorët e sistemit të shpërndarjes, operatorët e sistemit të depozitimit dhe operatorët e sistemit të GNL-së.

2. Konfidencialiteti i informacionit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit.** Nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe mekanizmave të tjerë juridik, OST siguron konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar, financiare ose teknike të cilat iu vijnë drejtuesve ose punonjësve të shoqërisë gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre profesional. OST ruan informacionin konfidencial të cilësuar si të tillë sipas kontratave me furnizuesit e produkteve dhe/ose shërbimeve. Këta furnizues duhet të sigurojnë që drejtuesit dhe punonjësit e tyre, që e marrin këtë informacion konfidencial nga OST, ta ruajnë konfidencialitetin në lidhje me këtë informacion. Staf i shoqërisë ka marrë të gjitha masat që materialet që kanë informacion të ndjeshëm tregëtar siç janë (dokumentat, arkivues të të dhënave elektronike, kompjutera, tableta, telefonat etj.) të mbrohen në bazë të protokolleve në fuqi sipas vendit të punës. OST gjithashtu nuk shpërndan informacionin e ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë, përveç rasteve kur: Shpërndarja e informacionit kërkohet shprehimisht nga ligji, duke siguruar që kjo shpërndarje të kryhet sipas një mënyre të përcaktuar me ligj. Drejtuesit dhe/ose punonjësit e OST sigurojnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregëtar të cilët e kanë në dispozicion për shkak të detyrës profesionale. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshillëtarët nuk shpërndajnë ose kanë shpërndarë informacion të ndjeshëm tregëtar tek ndonjë palë e tretë gjatë emërimit të tyre, punësimit ose bashkëpunimit me OST dhe të paktën 3 (tre) vitet në vazhdim pas mbarimit të emërimit, punësimit, dhe bashkëpunimit (vetëm sipas rasteve të cituara në ligj). Në përputhje me kërkesat e transparencës të OST, siguron që të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të trajtohen në mënyrë jo diskriminuese dhe me kushte të njëjta kur ofrohet informacioni funksional dhe informacionet e tjera që kanë lidhje me aktivitetet e OST. Nëse ndonjë informacion i ndjeshëm tregëtar duhet të shpërndahet, duhet të sigurohet që ky informacion është shpërndarë për të gjithë pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit duke e publikuar atë në

faqen e internetit të OST. Zyrtari së bashku me OST po draftojnë një rregullore të tillë dhe pritet që stafi të trajnohet nga Zyrtari mbi këto kërkesa.

3. Informacioni publik

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit.** OST ka publikuar në faqen e internetit informacionet që nuk klasifikohen si konfidencial ose informacione të ndjeshëm tregëtar duke vendosur në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve, përdoruesve të rrjetit dhe palëve të treta informacionin e lidhur me listën e shërbimeve të ofruara nga OST , informacion për tarifatat dhe kushtet e tjera për sigurimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë kushtet teknike për aksesin dhe lidhjen me sistemin e transmetimit.

D. Zbatimi i Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, është i krijuar i tillë që të ketë formën e një rregulloreje, apo udhëzimi me angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit dhe punonjësit, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të OST, siç janë audituesit, këshilltarët, kontraktuesit, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit si dhe palët e tjera të treta.

Zyrtari me shkresën nr.34 prot. Datë 20.02.2020 lënda “kërkohet informacion mbi vendimin e fundit për certifikimin e ALBGAS sh.a.”ka kërkuar që OST të përmbushi kërkesat e ERE tek vendimi nr.63 datë 23.04.2019 për një ndryshim në vendimin e bordit ERE nr.179, datë 8.11.2017, “mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” ALBGAS sh.a.”. Zyrtari me shkresën nr.35 prot. Datë 20.02.2020 lënda “Informacion mbi vendimet e fundit për certifikimin dhe licensimin e ALBGAS sh.a.” ka informuar bordin për detyrimet ligjore të OST për vitin 2020.

Duhet theksuar insistimi nga ERE ku me vendim Nr. 63, për një ndryshim në vendimin e bordit ERE nr.179, datë 8.11.2017, “mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” ALBGAS sh.a.” datë 24.04.2019 vendosi: OST të dorëzojë Programin deri më 31 Maj 2019 për arsye përmbushje të kushteve të certifikimit: Programi duhet të miratohet nga Asambleja përpara se të miratohet nga ERE.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, dhe shkresës së OST nr. Prot 71/2, datë 02/06/2020 “Kthim përgjigje shkresës tuaj 71/1 datë 11.03.2020”: **OST i plotëson kërkesat e Programit.** Referuar vendimit Nr.78 datë 26.05.2017 të ERE, monitorimi i vazhdueshëm për zbatimin, siç duhet, të Programit është kryer nga Zyrtari i Përputhshmërisë i cili ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të ofruara sipas Ligjit Nr 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe kontratës së lidhur midis OST dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë. Zyrtari i Përputhshmërisë ka ushtruar autoritet të mjaftueshëm në kushtet e dhëna financiare dhe organizuese që i kanë mundësuar, propozimin e masave për të siguruar zbatimin e këtij Programi dhe të kërkojë bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit e OST për të siguruar përputhshmërinë me këtë Program. Zyrtari i Përputhshmërisë ka pasur akses pa limit tek të dhënat e nevojshme në zyrat e OST dhe tek

gjithë informacioni që i është dashur për të kryer detyrat e tij. Zyrtaari i Përputhshmërisë ka pasur akses në zyrtat e OST pa pasur nevojën e një njoftimin paraprak. Zyrtaari i Përputhshmërisë ka marrë pjesë në një pjesë të madhe të mbledhjeve të drejtuesve të OST dhe organeve korporative, përfshirë asamblenë e përgjithshme, organet mbikqyrëse dhe drejtuese, të cilat e kanë informuar Zyrtaarin e Përputhshmërisë paraprakisht për takimet e programuara dhe i ka siguruar të gjithë informacionin dhe materialet e nevojshme për të marrë pjesë në takime. Gjatë kryerjes së aktiviteteve të tij, Zyrtaari i Përputhshmërisë ka dhënë opinionin e tij në lidhje me disa dokumenta të brendshëm si dhe veprime të OST në lidhje me përputhshmërinë e tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e OST, përfaqësuesit e autorizuar, audituesit dhe këshilltarët kanë konfirmuar me shkrim që janë të informuar për Programin dhe që do ta zbatojnë atë. Të gjithë drejtuesit e OST dhe punonjësit janë udhëzuar rregullisht për zbatimin e këtij programi të paktën një herë në vit. Drejtuesit e rinj dhe punonjësit janë udhëzuar për programin nga Zyrtaari i Përputhshmërisë para se të fillojnë mandatin e tyre.

PJESA E DYTË

4. Rekomandimet e pranuar të Zyrtaarit të Përputhshmërisë

Në raportin e vitit 2019, OST nga rekomandimet e marra, vetëm një rekomandim është ka pranuar dhe aplikuar.

- **Paraqitja e teknikave të reja për trajnimet e stafit**

Zyrtaari ka rekomanduar që në vitin 2018 të bëheshin trajnime për stafin e OST. OST në vitin 2019 ka pranuar rekomandimin e Zyrtaarit për të zhvilluar trajnime duke pasur parasysh teknikat e reja për gazin, rregulloret për gazit, trajnime mbi zhvillimit e fundit në fushën e gazit dhe gjithashtu dhe seminare dhe grupe pune për zhvillimin e tregut të gazit dhe kompanisë OST. Ky rekomandim quhet i ezauruar por trajnimet do vazhdojnë dhe për vitin 2020.

5. Rekomandimet e Zyrtaarit të Përputhshmërisë për vitin 2020

Sipas shkresës së ERE nr. 411/1 prot. Datë 26.08.2019 “Kërkesë për informacion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të zyrtaarit të përputhshmërisë”. OST me shkresën Nr. 87 prot. Datë 12/09/2019 kanë kthyer përgjigje disa nga rekomandimet duke thënë: nuk janë plotësuar.

- **Përditësimi i faqes zyrtare të OST**

Zyrtaari ka rekomanduar që në vitin 2018 të bëheshe përditësimi i faqes zyrtare online të OST. OST duhet të kishte marrë në konsideratë rekomandimi dhe të bënte përditësimin e duhur të faqes zyrtare. OST është duke ngritur dhe përditësuar faqen e saj zyrtare të web-it sipas kërkesave ligjore dhe rekomandimeve të Zyrtaarit të Përputhshmërisë.

Sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 102/2015, datë 23.09.2015, “ Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe kërkesat e Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, Zyrtaari duhet të ketë një rubrikë të veçantë për Përputhshmërinë në faqen zyrtare të OST (www.albgaz.al).

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2019

Së dyti, për të siguruar përputhshmërinë me programin duhet të krijohet një kanal komunikimi ndërmjet Zyrtarit, Stafit, klientëve, publikut, dhe përdoruesve të gazit natyror. Komunikimi ka për qëllim të sigurojë që Zyrtari të fitojë njohuri për të gjitha incidentet e mospërputhjes në lidhje me sjelljen jo etike ose të paligjshme (p.sh. konfliktet e interesit, zbulimi i informacionit komercialisht të ndjeshëm, trajtimi diskriminues i Përdoruesve të Sistemit, mosrespektimi i Programit të Përputhshmërisë), dhe që anonimiteti i personave që raportojnë këto incidente të jetë plotësisht i mbrojtur. Kanali i komunikimit realizohet në tre mënyra të ndryshme:

- me anë të plotësimit të formularit e dorëzimit elektronik nëpërmjet faqes së internetit të korporatës (www.albgaz.al),
- me postë,
- e-mail (zyrtari@albgaz.al : elvis.ponari@albgaz.al)

Ky rekomandim do kërkohe të plotësohet në 2020.

- **Përmirësimi i Kodit të Etikës duke përfshirë dhe Programin**

Kodi i Etikës aktual i përdorur nga OST është shumë i mirë por kërkon një përmirësim duke shtuar pjesë nga Programi i Përputhshmërisë. Do shikohet përgjatë vitit 2020 nëse ky rekomandim vertet mund të jetë i tepër ose duhet të rikonsiderohet.

- **Udhëzues: Politikat e Programit të Përputhshmërisë**

Zyrtari për vitin 2020 do të krijojë një udhëzim për katër parimet e programit, pasi në vitin 2019 nuk ishte e mundur të mbaronte për shkak që dhe programi u miratua me vonesë në OST. Ky udhëzim do shërbejë si dokument i brendshëm për të informuar punonjësit mbi Programin e Përputhshmërisë. Është shumë e rëndësishme që me anë të këtij udhëzimi të punonjësit të njohin dhe plotësojnë të gjitha kërkesat e Programit. Ky rekomandim do kërkohe të plotësohet në 2020.

- **Udhëzues për Politikat e klasifikimit të dokumentacionit**

Zyrtari ka rekomanduar që në vitin 2018 të mblidhej një grup pune dhe të krijoheshë një udhëzues për politikat e klasifikimit të dokumentave. OST duhet të krijonte një udhëzues për klasifikimin e dokumentacionit sipas kërkesave të Programit, kapitulli B “Konfidencialiteti i informacionit”. Ky udhëzues mund të përfshihet tek Kodi i Etikës së OST. Zyrtari do jetë në bashkëpunim me OST për të përfunduar këtë rekomandim.

Në shkresën e ERE Nr. 411/1 prot 26.08.2019, për “Kërkesë informacioni lidhur me zbatimin e rekomandimeve të zyrtarit, nga ana e shoqërisë ALBGAS sh.a.” OST ka vënë me dije me përgjigjen sipas shkresës Nr. 87 Prot. Datë 12.09/2019, për “Informim rreth rekomandimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë” për zbatimin e këtij rekomandimi në vitin 2019 sipas shkresës thuhet:

- Trajnimet e stafit mbi ruajtjen e konfidencialitetin e të dhënave/sekretit tregtar – stafi i OST është i përditësuar rreth ndjeshmërisë për ruajtjen e të dhënave/sekretit tregtar konfidencial i përfshirë tek Kodi i Etikës.

Ky rekomandim do kërkohe të rishikohet në 2020.

- **Përditësim/përmirësim i Programit**

Programi është në vitin e dytë të aplikimit në OST. Meqenëse programi është koncept i ri në përdorim dhe funksion, do të ketë një grup pune për të rishikuar dhe për të përmirësuar/ndryshuar

këtë program në përputhje me kërkesat e BE-së. Kjo për faktin se kërkesat ligjore mund të kenë ndryshuar dhe/ose janë shtuar, të cilat në fund do të duhet të reflektohen në program. Ky rekomandim do të kërkohej të përmbushet në vitin 2020.

- **Mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e Programit**

Zyrtari ka rekomanduar për zhvillimin e një mekanizmi për të komunikuar dhe lehtësuar informacionin e mbledhur nga programi. Një management information system/sistem i menaxhimit të informacionit (MIS) do të shtohet si mjet komunikimi në OST. Është një sistem informacioni (IT) i përdorur për vendimmarrje, për koordinim, kontroll, analizë dhe vizualizim të informacionit në një organizatë, veçanërisht në një kompani të madhesi OST. Ky sistem do të krijohet dhe hartohet nga zyrtari së bashku me OST në vitin 2020.

- **Zgjerimi i burimeve njerëzore dhe trajnime**

OST është një shoqëri tregtare në rritje dhe me perspektive të lartë. Për të zhvilluar tregun e gazin vëndas, që momentalisht është në nivele bazike, OST duhet të zgjerojë dhe shtojë burimet njerëzore për vitin 2020.

PJESA E TRETË

6. Detyrat specifike të lëna nga ERE mbas miratimit të Raportit 2018.

Disa probleme për të ardhmen në sektorin e gazit natyror të cilat do jenë si detyra për Zyrтарin janë si më poshtë:

- Ndjekja me përparësi e Projektit TAP sepse është viti vendimtar i vendosjes në punë të tij
- Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së. Koordinimi i të gjitha akteve nënligjore dhe rregulloreve në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim
- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Energjisë në Vjenë për aktet e tjera të mbetura nënligjore dhe konsulenca e vazhdueshme për problemet që dalin gjatë hartimit të tyre
- Nga ana e ministrisë së linjës (MIE) është domosdoshmëri ndërtimi i infrastrukturës së gazit si një nevojë urgjente për hapjen e tregut të gazit natyror në vëndin tonë. Tashmë janë identifikuar pesë projekte prioritare të miratuara edhe nga Këshilli i Ministrave dhe kërkohej fillimi i ndërtimit sipas prioritetit
- Bashkëpunimi me MIE dhe me OST, në aspektin rregullator, për të gjitha problemet që hasen për hapjen e tregut të gazit natyror.
- Bashkëpunimi me institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare për problemet e gazit, marja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë.

PJESA E KATËRT

7. Konkluzione

Raporti i parashtruar përcakton se, në vitin 2019 (viti i dytë i zbatimit të Programit të Përputhshmërisë), OST ka filluar dhe vazhduar me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në mënyrë të saktë që nga dita e çertifikimit të tij. Drejtuesit dhe Staf i kompanisë, kanë ndjekur në masë të madhe kuadrin rregullator specifik të ofruar nga Programi.

Raporti i vitit 2019 nuk nxjerr në pah ndonjë shkelje apo nuk konstaton që OST të ketë shkelur apo të mos ketë plotësuar kërkesat për përputhshmërinë e kompanisë.

Modeli OST dhe OSSH (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror) i përzgjedhur nga OST, referuar Vendimit Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., është duke u zbatuar me sukses, në përputhje me kuadrin ligjor në përputhje me tregun e gazit.

Përgjatë vitit 2019 në funksionim e shoqërisë OST kanë ndodhur shumë ndryshime dhe përmirësime. Mund të themi që mangësitë e 2018 janë plotësuar në masë, dhe 2019 ka lënë hapur të vetmin problematikë – çertifikimin dhe licensimin e OST. Ky vit ka qënë aq mbresëlënës për OST, aq sa ka marrë dhe licencën për depozitues gazit. Një projekt gjigand dhe domethënës për rajonin. Gjithësesi, mbeten detyra, çështje dhe procedura të hapura, të përmendura më lart, që do ndiqen nga Zyrtari përgjatë 2020, duke u përmirësuar ose duke u mbyllur si detyra. Duhet përmendur rekomandimet e Zyrtarit të cilat do rishikohen përgjatë 2020.

Duhet theksuar që OST, nën dijeninë e Zyrtarit, është në komunikim të rregullt me ERE për plotësimin e kërkesave ligjore. Zyrtari është marrë me koordinimin e komunikimit me ERE, me autoritetet e tjera kompetente, pjesëmarrësit ose me palët e treta që kanë lidhje me zbatimin e këtij Programi. Gjithashtu OST ka komunikim të mirë me Zyrtarin për zbatimin dhe respektimin e programit, sa herë që kërkohej, si pjesë e detyrave të dala nga Programi.

Në kushtet që ndodhet tregu i gazit në vënd, zhvillimi i aktivitetit të OST dhe zhvillimi i tregut të gazit është një proces i rëndë si në volume projektimi dhe financimi. Kërkohej gjithashtu dhe burime njerëzore të mëdha dhe të kushtueshme, sëbashku me shtrirje kohore të zgjeruara. Por për të arritur këto rezultate në mënyrë graduale duhet që OST të:

- Krijoj kushtet për përfundimin e investimeve të huaja direkte në këtë segment të industrisë;
- Rritjen e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
- Përmirësimin e furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
- Krijimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kostosh energjitike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
- Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
- Krijimin e kapaciteteve njerëzore në vënd në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

Viti 2020 e pret OST me zhvillimi në fushën e gazit si:

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë - 2019

- Përpjekjet për zhvillimin e sektorit të gazit në Shqipëri gjatë vitit 2020 e më tej. Si zhvillimi i linjës së parë të gazsjellësit Fier-Vlorë, me një qëllim të dyfishtë, furnizimin me gaz të TEC-it të Vlorës dhe zhvillimin e rrjetit të distribucionit në qytetin e Vlorës.
- Zhvillimi i mëtejshëm i qarkut të Fierit pasi aty kalon TAP.
- Zhvillimi i mëtejshëm i qarkut të Korçës pasi aty kalon TAP
- Zhvillime të tjera afatgjate është dhe lidhja me gaz e dy qyteteve më të mëdha Tirana dhe Durrësi. Më tej dhe Elbasani.
- Ndjekja e projektit Amerikan për shpërndarjen e GNL me kontinier. Për mendimin tim, mbase është një projekt konkurrues kundrejtë OST.
- Bashkëpunim me BERZH për trajnimin e stafit.

Tiranë, 23.07.2020

Elvis Ponari, MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAZ Sh.a

Elvis Ponari

